

Raporti i auditorit dhe pasqyrat financiare

Për:
Instituti Riinvest

Viti: 2019

RIINVEST - INSTITUTI PËR ZHVILLIM

**PASQYRAT FINANCIARE DHE RAPORTI I AUDITIMIT NGA AUDITORI I
PAVARUR PËR VITIN QË PËRFUNDON ME 31 DHJETOR 2019**

Përmbajtja

Raporti i Audituesve të pavarur	3
Pasqyra e Pozicionit Financiar me 31 Dhjetor 2019	5
Pasqyra e të ardhurave përmbledhese për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2019	6
Pasqyra e flukseve monetare për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2019	7
Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për fundin e viti 31 Dhjetor 2019	8

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për Menaxhmentin e RIINVEST - Instituti për Zhvillim

Opinion

Kemi audituar pasqyrat financiare të “RIINVEST-Instituti për Zhvillim” Prishtinë të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar me 31 dhjetor 2019, pasqyra e të ardhurave dhe pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin që përfundoi në atë datë, dhe shënimet e pasqyrave financiare, përfshirë një përmbledh-je të politikave më të rëndësishme kontabël.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të organizatës me 31 dhjetor 2019, të performancës financiare dhe rrjedhës së parasë për vitin që përfundoi në atë datë dhe janë në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për opinionin

Auditimin e kemi kry në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tutje në seksionin *Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare të këtij raporti*.

Jemi të pavarur nga organizata në pajtueshmëri me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionist të Bordit Ndërkombëtar të Standardeve të Etikës (Kodi i IESBA) së bashku me kërkesat që janë relevante gjatë auditimit të pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona tjera etike në pajtueshmëri me këto kërkesa dhe Kodin e IESBA.

Besojmë se evidanca e përftuar e auditimit është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazë të arsyeshme për opinion.

Thëksim i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen në Shpalosjen “Parimi i vijimësisë së afarizmit” (Fq.17.) dhe “Ngjarjet pas përfundimit të periudhës së raportimit” (Fq.17-18) të pasqyrave financiare, që përshkruajnë efektet e përhapjes së pandemisë COVID-19 në vijimësinë e aktiviteteve të tanishme të organizatës dhe në periudhat e ardhshme raportuese.

Opinionin ynë nuk është ndikuar nga këto çështje.

Çështjet Kryesore të Auditimit

Çështje Kryesore të Auditimit janë ato çështje që, në gjykimin tonë profesional, kanë qënë më të rëndësishmet në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Këto çështje kanë qënë adresuar në kontekstin e auditimit të pasqyrave financiare në tërësi dhe të formimit të opinionit tonë në lidhje me to, kështu që për këto çështje, ne nuk japim opinion të veçantë.

Vijimësia

Pasqyrat financiare, janë përgatit mbi bazën e vijimësisë, drejtimi nuk ka për synim likuidimin as ndërprerjen e veprimtarisë së vetë për 12 muajt e ardhshëm.

Auditimi nuk ka identifikuar ekzistencën e ngjarjeve apo kushteve të cilat krijojnë dyshime mbi aftësinë e organizatës për të vazhduar në vijimësi. Mirepo e mbajm skepticizmin lidhur me masat që ka ndermarr qeveria për shitjen e thengjillit si dhe qendrueshmerine jo stabile të klientit NewCo Ferronikeli, i cili përmbajn mbi shumicën e të hyrave.

Informacione të tjera të ndryshme nga Pasqyrat Financiare

Informacione tjera, financiare ose jo financiare që ndryshojnë nga pasqyrat financiare të audituara dhe raporti i audituesit mbi këto pasqyra, të përfshira në raportin vjetor të entitetit dhe kanë mospërputhje materiale me PF ose me njohjen e siguruar nga audituesi gjatë auditimit, ku çdonjëra prej tyre mund të dëmtojë besueshmërinë e PF dhe të raportit të audituesit mbi këto pasqyra, nuk janë identifikuar.

Përgjegjësitë e drejtimi dhe personave të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Drejtimit është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në pajtueshmëri me SNRF dhe për kontrolle të tilla të cilat drejtimi mendon se janë të domosdoshme për të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së organizatës të vij-obje sipas hipotezës së vijimësisë, duke shpalosur, nëse është e zbatueshme, çështjet lidhur me hipotezën e vijimësisë

dhe duke përdorur bazën e kontabilitetit bazuar në vijimësi përveç nëse drejtimi ka për qëllim të likuidojë ose të ndërpresë aktivitetet e kompanisë, ose nuk ka ndonjë alternativë tjetër përveç të veprojë në këtë mënyrë.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të organizatës.

Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të përftojme siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të japim një raport të auditorit që përfshinë opinion-in tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk është garanci se auditimi i kryer sipas SNA gjithmonë do të zbulojë anomali materiale në rast se ato ekzistojnë. Anomalitë mund të paraqiten nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen që janë materiale nëse, individualisht ose të grumbulluara, ato mund të ndikojnë në mënyrë të arsyeshme në vendimin që marrin përdoruesit bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në pajtueshmëri me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional përgjatë tërë auditimit.

Ne gjithashtu jemi përgjegjës të:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit si përgjigje ndaj këtyre rreziqeve dhe përftojme evidenca të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të na ofruar bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të anomalive materiale për shkak të mashtrimit është më i lartë se ai i shkaktuar nga gabimet, pasi që mashtrimi mund të përfshijë marrëveshjet e fshehta, falsifikimin, lënjen anash me qëllim, keqinterpretimin ose anashkalimin e kontrolleve.
- Përftojme njohuri mbi kontrollet e brendshme që janë relevante për auditimin në mënyrë që të projektojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për ato rrethana, por jo me qëllim të japim një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të organizatës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjeve përkatëse nga drejtimi.
- Përfundojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të hipotezës së vijimësisë nga ana e drejtimit dhe bazuar nga evidenca e përftuar e auditimit, nëse ekziston ndonjë pasiguri materiale lidhur me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshim domethënës mbi aftësinë e organizatës për të vijuar ekzisten-cën. Nëse arrijmë në përfundim se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit në shpalosjen përkatëse të pasqyrave financiare ose, nëse një shpalosje e tillë është e pamjaftueshme, ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të përfthuara deri në datën e raportit të auditorit. Mirëpo, ngjarjet dhe kushtet e ardhshme mund të shkaktojnë që organizata të mos vijojë aktivitetet e saj.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjen nëse pasqyrat financiare përfaqësojnë transaksionet dhe ngjarjet përkatëse në mënyrë që të arrihet paraqitja e drejtë.

Kemi komunikuar me personat e ngarkuar me qeverisjen, në mes tjerash edhe lidhur me fushëveprimin e planifikuar, kohën e auditimit dhe gjetjet domethënës të auditimit, përfshirë çfardo mangësi domethënës në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

Audit Office SH.P.K

NRB: 70869586
FIN: 600840301
Xhemail Sylja
Prishtina
Republika e Kosovës
Tel. 044/156-921
E-mail: xhemail.sylja@gmail.com

Data

RIINVEST - Instituti per Zhvillim			
Pasqyra e pozitës financiare			
më 31 dhjetor 2019			
FIN: 600029400			
	Shënimi	2019	2018
		€	€
PASURITË			
Pasuritë afatshkurtra			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	3	69,526	62,937
Investimet financiare afatshkurtra			
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	4	9,387	2,672
Stoqet	5	2,623	2,660
Pasuritë e tjera afatshkurtra	6	1,088	
Gjithsej pasuritë afatshkurtra		82,624	68,269
Pasuritë afatgjata			
Investimet në pjesëmarrje			
Investimet në filiale			
Investimet financiare afatgjata			
Prona, pajisjet dhe impiantet	7		252
Prona investuese			
Investimet në vijim			
Pasuritë e paprekshme			
Pasuritë e shtyra tatimore			
Pasuritë e tjera afatgjata			
Gjithsej pasuritë afatgjata		-	252
Gjithsej pasuritë		82,624	68,521
DETYRIMET DHE EKUITETI			
DETYRIMET			
Detyrimet afatshkurtra			
Mbitërheqja bankare			
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	8	13,710	54,977
Kreditë dhe huatë, pjesa afatshkurtër			
Interesi i pagueshëm			
Tatimin në fitim i pagueshëm			
Provizionet afatshkurta			
Detyrimet ndaj lizingut financiar, pjesa afatshkurtër			
Detyrimet e tjera afatshkurtra	9	124	
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		13,834	54,977
Detyrimet afatgjata			
Kreditë dhe huatë, pjesa afatgjatë			
Provizionet afatgjata			
Detyrimet ndaj lizingut financiar, pjesa afatgjate			
Detyrimet e shtyra tatimore			
Detyrimet e tjera afatgjata	10	68,790	13,544
Gjithsej detyrimet afatgjata		68,790	13,544
Gjithsej detyrimet		82,624	68,521
EKUITETI			
Kapitali aksionar			
Fitimet e mbajtura			

Rezervat e tjera			
Gjithsej ekuiteti			
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		82,624	68,521

Drejtori i përgjithshëm

Drejtori financiar /Kontabilisti i çertifikuar

RIINVEST - Instituti per Zhvillim			
Pasqyra e të ardhurave dhe fitimit të mbajtur			
për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019			
FIN: 600029400			
	Shënimi	2019	2018
		€	€
Të hyrat	11	347,237	371,024
Kostoja e shitjes	12	-37	-1,034
Fitimi / (humbja) bruto		347,200	369,990
Të ardhurat tjera	11	74	
Shpenzimet e shpërndarjes	13	-92,425	-97,445
Shpenzimet administrative	14	-254,597	-270,929
Shpenzimet e tjera	7	-252	-1,616
Fitimi / (humbja) operativ		-	-
Shpenzimet financiare		-	-
Të ardhurat financiare			
Fitimi / (humbja) para tatimit		-	-
Shpenzimet e tatimit në fitim		-	-
Fitimi / (humbja) i/e vitit		-	-

Drejtori i përgjithshëm

Drejtori financiar /Kontabilisti i çertifikuar

RIINVEST - Instituti per Zhvillim			
Pasqyra e rrjedhjes së parasë			
për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019			
FIN: 600029400			
	Shënimi	2019	2018
		€	€
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi / (humbja) i / e vitit		0	0
Rregullimet për zërat jo në para të shpenzimeve dhe të hyrave			
Zhvlerësimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve		252	1616
Dëmtimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve			
Amortizimi i pasurive të paprekshme			
Humbjet nga dëmtimi në pasuritë e paprekshme			
Ndryshimi i vlerës së pronës investuese			
Të ardhurat financiare			
Shpenzimet financiare		1714	
(Fitimi) / humbja nga shitja e pronës, fabrikës dhe pajisjeve			
Shpenzimet e tatimit në fitim			
		1966	1616
Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative			
(Rritja) / zvogëlim në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera		-6714	28449
(Rritja) / zvogëlimi në stoqe		37	25726
(Rritja) / zvogëlimi në pasuritë e tjera		-1088	
Rritja / (zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera			
Rritja / (zvogëlimi) në detyrimet e tjera		14102	-86617
		8303	-30826
Tatimi në fitim i paguar			
Interesi i paguar		-1714	
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative		6589	-30826
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese			
Pagesat për blerjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve			
Arkëtimet për shitjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve			
Pagesat për blerjet e pasurive të paprekshme			
Arkëtimet për shitjen e pasurive të paprekshme			
Interesi i arkëtuar			
Dividendat e arkëtuara			
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese		0.00	0.00
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese			
Deponimet e kapitalit shtesë			
Dividendat e paguara			
Arkëtimet nga kreditë dhe huatë			
Ripagimi i kredive dhe huave			
Pagesat e lizingut financiar			
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese		0	0
Rritja/(zvogëlimi) neto i parasë dhe ekuivalentëve të parasë		6589	-30826
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit		62937	93763
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit	3	69526	62937

Drejtori i përgjithshëm

Drejtori financiar /Kontabilisti i çertifikuar

RIINVEST-INSTITUTI PËR ZVHILLIM
Shënimet e Pasqyrave Financiare për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2019

1. HYRJE

RIINVEST - Instituti per Zhvillim (“Riinvest”) me nr. te regjistrimit prane Ministrisë se Administrates Publike 52001323, me numer fiskal pran Administrates Tatimore te Kosoves 600029400, është një Institut për kërkime dhe konsultime (think tank) e themeluar në territorin e Kosovës në vitin 1995. Misioni i saj është të promovojë një zhvillim modern ekonomik të Kosovës bazuar në filozofinë e ndërmarrjeve. Aktivitetet e saj përfshijnë:

- Studimet dhe analizat ekonomike;
- Administrata publike dhe studimet ligjore;
- Zhvillimi i NVM-ve;
- Zhvillimi i ekonomisë lokale;
- Edukimi
- Publikimi dhe avokimi

Riinvesti ka objektivat e saj te cilat jane

- Të kontribuojë në përmirësimin e ambientit për reforma të politikave ekonomike dhe të ndërtimit të kornizës së politikave makroekonomike dhe strukturale për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe aktivitet avokimi;
- Të perkrah sektorin privat të zhvillimit përmes promovimit të kulturës së ndërmarrjeve dhe zhvillimit të NVM-ve;
- Të rrisë zhvillimin institucional të Riinvestit përmes kërkimeve dhe kapaciteteve. si dhe zhvillimit të stafit drejt një organizate të qëndrueshme: dhe
- Të promovojë angazhimin e komunitetit të biznesit në procesin e politikave përmes mbështetjes dhe bashkëpunimit me Aleancën Kosovare të Biznesit

Për të arritur këto qëllime, Riinvest ka zhvilluar një spekter të gjerë të aktiviteteve përfshirë:

- Kërkime
- Avokim
- Asistencë teknike ndërkombëtare për zhvillimin insitucional të Riinvestit dhe për ngritjen e kapaciteteve të saj
- Asistencë teknike për asociacionet e bizneseve/zhvillimin e Aleancës Kosovare të Biznesit; dhe
- Edukim

1. Bazat e përgatitjes dhe politikat kontabël

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardin Ndërkombëtarë të Raportimit Financiar për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (SNRF për NVM-të) të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit. Ato janë paraqitur në njësi monetare Euro.

Investimet në pjesëmarrje

Investimet në pjesëmarrje janë kontabilizuar sipas metodës së kostos minus çdo humbje të akumuluar nga dëmtimi (rënia në vlerë).

Të ardhurat nga dividendat nga investimet në pjesëmarrje njihen kur e drejta e Grupit për të marrë pagesën është vendosur. Kjo e ardhur është përfshirë në të ardhurat e tjera.

Njohja e të hyrave

Të hyrat nga shitja e mallrave njihen kur mallrat janë dorëzuar dhe pronësia është bartur.

Kostot e huamarrjes

Të gjitha kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave në periudhën në të cilën kanë ndodhur.

Tatimi në fitim

Tatimi në fitim paraqet shumën e tatimit të pagueshëm aktual dhe të tatimin e shtyrë (nese ka). Tatimi i pagueshëm aktual është i bazuar në fitimin e tatueshëm të vitit. Shoqeria nuk ka tatim në fitim për vitin aktual.

Tatimi i shtyrë njihet nga diferencat ndërmjet vlerës kontabël të pasurive dhe detyrimeve në pasqyrat financiare dhe bazat e tyre përkatëse tatimore (të njohura si diferencat e përkohshme). Detyrimet e shtyra tatimore njihen për të gjitha diferencat e përkohshme të cilat pritet të rrisin fitimin e tatueshëm në të ardhmen. Pasuritë e shtyra tatimore njihen për të gjitha diferencat e përkohshme të cilat pritet të zvogëlojnë fitimin e tatueshëm në të ardhmen dhe çdo humbje tatimore ose kreditim tatimor të papërdorur. Pasuritë e

RIINVEST-INSTITUTI PËR ZVHILLIM
Shënimet e Pasqyrave Financiare për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2019

shtyra tatimore maten me shumën më të lartë që, në bazë të fitimit të tatueshëm të tanishëm ose të ardhshëm të vlerësuar, ka më shumë gjasa që të rimerret sesa që të mos rimerret.

Vlera kontabël neto e pasurive të shtyra tatimore rishikohet në çdo datë të raportimit dhe rregullohet për të pasqyruar vlerësimin aktual të fitimeve të tatueshme në të ardhmen. Çdo rregullim njihet në fitim ose humbje.

Tatimi i shtyrë është llogaritur duke përdorur normën tatimore që pritet të zbatohet në fitimin e tatueshëm (humbjen e tatueshme) të periudhave në të cilat tatimi i shtyrë si aset pritet që të realizohet ose detyrimet e shtyra tatimore që të zgjidhen, në bazë të normave tatimore që janë në fuqi ose që do të jenë në fuqi deri në fund të periudhës raportuese.

Prona, pajisjet dhe impiantet

Prona, pajisjet dhe impiantet janë matur me kosto minus zhvlerësimi i akumuluar dhe çdo humbje e akumuluar nga dëmtimi (rënia në vlerë).

Zhvlerësimi ngarkohet në mënyrë që të ndahet kosto e pasurive minus vlera e tyre e mbetur përgjatë jetës së përdorimit të parashikuar, duke përdorur metodën lineare. Normat vjetore të mëposhtme janë përdorur për zhvlerësimin e pronës, impianteve dhe pajisjeve:

Ndërtesat	5 për qind
Impiantet	20 për qind
Pajisjet, mobilieritë, kompjuterët	20 për qind

Nëse ka një tregues se ka pasur një ndryshim të rëndësishëm në normën e zhvlerësimit, jetën e dobishme ose vlerën e mbetur të një pasurie, zhvlerësimi i kësaj pasurie rishikohet në mënyrë prospektive për të pasqyruar pritshmëritë e reja.

Pasuritë e paprekshme

Pasuritë e paprekshme janë softueri kompjuterik i blerë që njihet me koston minus amortizimin e akumuluar dhe çdo humbje të akumuluar nga dëmtimi (rënia në vlerë). Amortizohen gjatë jetës së tyre të llogaritur prej 5 vjetësh duke përdorur metodën lineare sipas kontratës. Nëse ka një tregues se ka pasur një ndryshim të rëndësishëm në normën e amortizimit, jetës së dobishme ose vlerës së mbetur të një pasurie të paprekshme, amortizimi rishikohet në mënyrë prospektive për të pasqyruar pritshmëritë e reja.

Dëmtimi (rënia në vlerë) i pasurive

Në çdo datë të raportimit, prona, pajisjet dhe impiantet, pasuritë e tjera të paprekshme dhe investimet në pjesëmarrje rishikohen për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues se këto pasuri kanë pësuar ndonjë dëmtim, përkatësisht ndonjë humbje nga rënia në vlerë. Nëse ka një tregues për rënie të mundshme, shuma e rikuperueshme e çdo pasurie të prekur (ose grup pasurish të ngjashme) vlerësohet dhe krahasohet me vlerën e saj kontabël. Në qoftë se shuma e vlerësuar e rikuperueshme është më e ulët, vlera kontabël ulet deri në shumën që vlerësohet se do të merret, ndërsa shuma e dëmtimit (humbja nga rënia në vlerë) njihet menjëherë në pasqyrën e të ardhurave.

RIINVEST-INSTITUTI PËR ZVHILLIM
Shënimet e Pasqyrave Financiare për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2019

Në mënyrë të ngjashme, në çdo datë të raportimit, stoqet vlerësohen për rënie të vlerës duke krahasuar vlerën kontabël neto të çdo artikulli të stoqeve (ose grupit të artikujve të ngjashëm) me çmimin e tij të shitjes minus kostot e shitjes. Nëse një artikull i stoqeve (ose grupi i artikujve të ngjashme) është i dëmtuar, vlera e tij kontabël reduktohet për çmimin shitës minus kostot e shitjes, dhe humbja nga rënia në vlerë njihet menjëherë në pasqyrën e të ardhurave.

Në qoftë se dëmtimi (humbja nga rënia në vlerë) më pas kthehet, vlera kontabël e pasurisë (ose grup pasurish të ngjashme) rritet për vlerësimin e rishikuar të shumës së tij të rikuperueshme (çmimi shitës minus kostot e e shitjes, në rastin e stoqeve), por jo në tejkalimin e shumës që do të ishte përcaktuar nëse nuk do ishte njohur asnjë humbje nga rënia në vlerë për pasurinë (grup pasurish të ngjashme) në vitet e mëparshme. Një anulim i një humbjeje nga rënia në vlerë njihet menjëherë në pasqyrën e të ardhurave.

Lizingu

Lizingu klasifikohet si qira financiare sa herë që transferohen në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së pasurisë të dhënë me qira **RIINVEST-INSTITUTI PËR ZHVILLIM**. Të gjitha kontratat e tjera janë klasifikuar si qira operative.

Të drejtat për pasuritë e mbajtura si lizing financiar njihen si pasuri të **RIINVEST-INSTITUTI PËR ZHVILLIM** në vlerën e drejtë të pronës së dhënë me lizing (ose, në qoftë se vlera është më e ulët, vlera aktuale e pagesave minimale të lizingut) në fillimin e lizingut. Detyrimi që korrespondon me qiradhënësin është përfshirë në pasqyrën e pozicionit financiar si një detyrim i qirasë financiare. Pagesat e qirasë ndahen mes të pjesës financiare dhe uljes së detyrimit të qirasë në mënyrë që të arrihet një normë konstante e interesit në bilancin e mbetur të detyrimit. Shpenzimet financiare zbriten gjatë kalkulimit të fitimit ose humbjes. Pasuritë e mbajtura me lizing financiar janë të përfshira në kuadër të zërit prona, pajisjet dhe impiantet, të cilat zhvlerësohen dhe vlerësohen për dëmtim (humbje nga rënia në vlerë) në të njëjtën mënyrë si pasuritë e tjera ne pronësi. (kontrata per qira eshte 1 vjeqare dhe nuk ka nevoj te behen perlllogaritje shtesë)

Lizingu i pagueshem operativ ngarkohet në pasqyrën e të ardhurave në baza lineare përgjatë afatit të kontratës së lizingut.

Stoqet

Stoqet janë prezantuar me vlerën më të ulët ndërmjet kostos dhe çmimit të shitjes minus kostot e kompletimit dhe shitjes. Kosto e stoqeve të shitura është llogaritur duke përdorur metodën FIFO

Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera

Shumica e shitjeve janë bërë në bazë të afateve normale të kreditimit, si dhe llogaritë e arkëtueshme nuk bartin interes. Ku kreditimi është zgjatur përtej afateve normale të kreditimit, llogaritë e arkëtueshme maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Të arëktueshmet tregtare të shprehura në monedhë të huaj shprehen në valutën Euro duke përdorur kursin e këmbimit në datën e raportimit.

Në fund të çdo periudhe raportuese, vlerat kontabël të llogarive të arkëtueshme tregtare dhe të tjera shqyrtohen për të përcaktuar nëse ka ndonjë evidencë objektive që shumat nuk janë të rikuperueshme. Nëse është kështu, një humbje nga dëmtimi (rënia në vlerë) njihet menjëherë në pasqyrën e të ardhurave.

RIINVEST-INSTITUTI PËR ZVHILLIM
Shënimet e Pasqyrave Financiare për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2019

Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera

Llogaritë e pagueshme tregtare janë detyrime në bazë të afateve normale të kreditimit dhe nuk bartin interes. Të pagueshmet tregtare të shprehura në monedhë të huaj shprehen në valutën Euro duke përdorur kursin e këmbimit në datën e raportimit. Fitimet ose humbjet e këmbimit valutor janë të përfshira në të ardhurat e tjera apo shpenzimet e tjera.

Kreditë bankare dhe mbitërheqjet

Shpenzimet e interesit regjistrohen në bazë të metodës së interesit efektiv dhe janë përfshirë në shpenzimet financiare.

Provizionet për detyrimet e garancisë

Mallrat e shitura me defekt eventual mund të zëvendësohen me mallra të rregullta pa defekt

3. Paraja dhe ekuivalentët e parasë

	2019	2018
	€	€
Paraja në arkë	175	104
Paraja në bankë	69,351	62,833
	69,526	62,937

4. Llogaritë e Arkëtueshme

Me 31 dhjetor	2019	2018
Avanset për stafin	492	761
ICMA-Kosovo impl. Of USAID LEGA	7997	
Arkëtimi për TVSH		1,068
ARTINI NTP	400	400
BUZUKU BOOK SHOP	80	80
DUKAGJINI SHPK	320	240
Paradhenie e tatimit në fitim	98	123
Total	9387	2,672

RIINVEST-INSTITUTI PËR ZVHILLIM
Shënimet e Pasqyrave Financiare për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2019

5. Stoqet

	2019	2018
	€	€
Libra-Ekonomia e Kosoves	2,623	2,660
	2,623	2,660

6. Pasurite tjera afatshkurtra

	2019	2018
	€	€
Parapagimi i TVSH 18%	1,062	0
Tatimi ne Qira	26	
	1,088	0

7. Makinat dhe paisjet

	Paisje për zyre	Automjete	Total
<i>Kosto Historike</i>			
Me 01 janar 2016	13,331	11,853	25,184
Shtesat			-
(Heqjet)			-
Me 01 janar 2017	13,331	11,853	25,184
Shtesat			-
(Heqjet)			-
Me 31 dhjetor 2017	13,331	11,853	25,184
Me 01 janar 2018	13,331	11,853	25,184
Shtesat			
(Heqjet)			
Me 31 dhjetor 2018	13,331	11,853	25,184
Me 01 janar 2019	13,331	11,853	25,184
Shtesat			
(Heqjet)			
Me 31 dhjetor 2019	13,331	11,853	25,184
<i>Zhvlerësimi i Akumuluar</i>			
Zhvlerësimi i Akumuluar deri me 01 janar 2016	-7,647	-6,519	-14,166
Zhvlerësimi i vitit	-2,215	-2,371	-4,586
Zhvlerësimi i Akumuluar deri me 01 janar 2017	-9,862	-8,890	-18,752
Zhvlerësimi i vitit	-2,193	-2,371	-4,564
Zhvlerësimi i Akumuluar deri me 31 dhjetor 2017	-12,055	-11,261	-23,316
Zhvlerësimi i vitit	-1,023	-593	-1,616
Zhvlerësimi i Akumuluar deri me 31 dhjetor 2018	-13,079	-11,853	-24,932
Zhvlerësimi i vitit	-252		-252
Zhvlerësimi i Akumuluar deri me 31 dhjetor 2019	-13,331	-11,853	-25,184
Vlera Neto në Libra me 31 dhjetor 2016	3,470	2,963	6,433
Vlera Neto në Libra me 31 dhjetor 2017	1,275	593	1,868
Vlera Neto në Libra me 31 dhjetor 2018	252	-	252
Vlera Neto në Libra me 31 dhjetor 2019	0	0	0

Vlera neto e kategorisë së pajisjeve, dhe automjete është zero.

RIINVEST-INSTITUTI PËR ZVHILLIM
Shënimet e Pasqyrave Financiare për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2019

8. Llogaritë e pagueshme dhe tjera

Me 31 dhjetor	2019	2018
Pishat shpk	56	
Audit Office shpk	2,000	
CETA - Gen.Inv.Group		43,955
Alban Zojag	1,347	
RILINDJA	27	37
Drop Sh.p.k.	1,780	
UNI-R	18	
Topline Electronics	557	
"AB in CO" Shpk	6,030	6,030
BUTTERFLY N.SH.		650
ENVINION Shpk		2,359
Europrinty shpk	24	
FUJI LIFT Shpk		120
KESCO	1,391	1,466
RIMA GROUP SH.P.K.		360
MC-Mercom Company-Peugeot	290	
Lesna Trade(Orion Hall)	190	
Total	13,710	54,977

9. Detyrimet tjera afatshkurtra

	2019	2018
Paga neto	124	
Total	124	

10. Detyrimet tjera afatgjata

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor	2019	2018
Te Hyrat e Shtyra UDAID/KOSOVO MCI	15,168	
European Commission SELDI3 (MCIC)	1,229	
Te Hyrat e Shtyra GIZ	17,472	13,292
Te Hyrat e Shtyra Kosovo Foundation for Open Society - Capital Investments	22,956	
Kcsf-Fondacioni Kosov. Per shoqeri civile	1,551	
BIRN-Balkkan Investigat. Reporting Network	10414	
Te Hyrat e Shtyra per Zhvlers.		252
Total	68,790	13,544

RIINVEST-INSTITUTI PËR ZVHILLIM
Shënimet e Pasqyrave Financiare për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2019

11. Të hyrat vete

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor	2019	2018
CIPE -Corporate Governance	252	432
European Commission Development ACAD.		1,184
European Commission-SELDI3 (MCIC)	5040	
USAID-CDF Intermunicipal Cooperation		16,970
DVV International-German Adult Educ. Assoc	20,000	
Kosovo Foundation for Open Society	24129	25,985
KCSF-Fondacioni Kosovar per Shoqeri civile	32,455	
UDAID/KOSOVO (MCI)	48596	66,242
USAID-ATRC	14598	23,408
CSD-Center for the Study of Democracy	2,398	
SWISCONTACT PPSE-Margin Share and Studies	81021	81,204
SWISCONTACT (KOS-PPSE)	12000	11,750
COUNCIL OF EUROPE Office In Prishtina		36435
U.S. EMBASSY PRISHTINA	16,248	
DAI GLOBALLC (X-index) USAID	23,462	17500
BIRN-Balkan Investigat. Reporting Network	140	
GIZ- Deutsche Gesellschaft fur Int.Zusamm.	17394	64,879
European Commision SELDI-Anti Corruption Initiative-		20961
ICMA-Kosovo Impl. of USAID LEGA	14540	
NDI for INTERN. AFFAIRS IMAD	34964	
Te Hyrat Tjera	74	4,074
Total	347311	371,024

12. Kosto e shitjes

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor	2019	2018
KMSH	37	1034
TOTAL	37	1034

13. Shpenzimet e Shperndarjes

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor	2019	2018
Shpenzimet e konsulente	18,171	
Anketuesit dhe Anketat	24	
Shpenzimet kontraktuese	18,462	
Shpenzimet e energjisë elektrike	3,719	4,120
Sherbimet Ligjore	1,707	

RIINVEST-INSTITUTI PËR ZVHILLIM
Shënimet e Pasqyrave Financiare për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2019

Shpenzimet e telefonit dhe postës	1,043	1,121
Shpenzimet Internetit & Website	153	52
Shpenzimet e programit		207
Shpenzimet e Auditimit	4,000	1,800
Shpenzimet për perkthim & zerim	1,490	
Përkthimet & Editimet		600
Akomodim&Ushqimi per pjesmarres	3,204	
Transporti	2,191	
Shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit		1,445
Shpenzimet per Anëtarësi		15
Shpenzimet e Perfaqësimit dhe Reklamës - Reprezentacionit	324	2,138
Shpenzimet për nxemje	1,050	1,782
Paisjet dhe Furnizimet	310	770
Provizionet bankare	1714	1,683
Shpenzimet e ndryshme		279
Publikimet, Banerat, Broshurat	5,906	9,837
Shpenzimet e aktiviteteve		33,985
Shpenzimet per automjete	1,181	2,215
Shpenzimet per trajnime, workshop, tryeza	851	7,469
Shpenzimet e ndryshmit te kursit		1,077
Gjobat	56	101
Shpenzimet tjera	911	
Shpenzimet për qira	19780	19780
Shpenzimet për material hargjues	525	969
Shpenzimet për Material të Zyrës	208	911
Shpenzimet e regjistrimit dhe servisim të veturës	1270	430
Shpenzimet e Shtypit Ditor	360	431
Shpenzimet e Ujit	515	928
Pastrimi&Mirembajtja	3300	3300
Total	92,425	97,445

14. Shpenzimet Administrative

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor	2019	2018
Shpenzimet e neto pagave	244830	260,608
Kontributet Pensionale	9767	10,321
Total	254,597	270,929

15. Detyrimet kontingjente

Subjekti ne fjale sipas deklarates se personave pergjegjes nuk ka detyrime kontigjente

23. Parimi vijimësisë së afarizmit

Raportet Financiare janë përgatitë mbi supozimin se organizata ka aftësinë dhe qëllimin që të vijojë dhe se do të vazhdojë të funksionojë në një të ardhme të parashikueshme (se paku 12 muaj) dhe drejtimi nuk ka vërejtë ndonjë vështërsi dhe as nuk ka synim apo nevojë të likuidojë ose të shkurtojë materialisht shkallën e operacioneve të veta.

Duhet cekur se në kohën e autorizimit të pasqyrave financiare për publikun, jemi në kohën e përhapjes së pandemisë COVID-19 prandaj jemi ballafaquar me një situatë të re dhe të panjohurë deri më tani, kjo na ka detyruar që të bëjmë organizim të ri të punës, ashtu që kemi organizuar punën prej ambienteve shtëpiake, prandaj pandemia na ka shkaktuar kufizim të lëvizjes por nuk kemi pas dëmtim të pasurive as ndërprerje të aktiviteteve pasi që ato i kemi zhvilluar online duke mbajtur kontakte të rregullta me personelin dhe organizatat tjera.

Pas përfundimit do të bëjmë sigurimin e një ambienti dhe orari të përshtatshëm për stafin me qëllim që të sigurojmë distancën e duhur sociale.

16. Ngjarjet pas përfundimit të periudhës raportuese

Subjekti ne fjalë nuk ka ngjarje kontestuese pas periudhes raportuese e cila mundet me qenë materiale.

Si ngjarje me ndikim që rritë pasigurinë dhe është duke ndodhur, konsiderojmë përhapjen e pandemisë COVID-19 që ka shkaktuar kufizim në lëvizjen e njerëzve. Qeveria ka marrë një sërë vendimesh dhe ka ndaluar përkohësisht operimin e shumë veprimtarive ekonomike.

Kjo krizë pritet të ketë efekte të rëndësishme ekonomike për subjektet, qoftë për shkak të kufizimeve në prodhim, tregti, konsum dhe shërbime, ose për shkak të kufizimeve në qarkullim.

17. Aprovimi i pasqyrave financiare

Pasqyra financiare janë aprovuar nga menaxhmenti dhe janë autorizuar për publikim më 27.03.2020